

D E K R E T
Nr.782, datë 22.2.1994

PËR SISTEMIN FISKAL NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KËRKIM - PRODHIM)

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

D E K R E T O J:

Neni 1

Kontraktuesi detyrohet të paguajë në çdo vit fiskal vetëm tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal. Fitimi i realizuar mund të shprehet në natyrë a në para, ose në formë të përzier, siç mund të parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Tatimi mbi fitimin është:

1. Në masën 50 për qind të fitimit të realizuar.

2. Në rast se kontraktuesi, në përputhje me nenin 12, pika 2, të ligjit "Për hidrokarburet" është Albpetroli dhe ky zotëron nga 50 për qind deri në 100 për qind të interesave në marrëveshje hidrokarburesh, tatimi është:

a) 30 për qind të fitimit të realizuar nga objektete zbuluara e të vëna në prodhim para datës 31.12.1993.

b) Për fitimin e realizuar nga zona të tjera (të vëna në prodhim pas datës 31.12.1993) tatimi është:

- 30 për qind për sasi hidrokarburesh të prodhuara deri në 20.000 barela në ditë.

- 50 për qind për çdo sasi hidrokarburesh shtesë të prodhuara nga 20.000 deri në 50.000 barela në ditë.

- 55 për qind për çdo sasi hidrokarburesh shtesë të prodhuar nga 50.000 deri në 65.000 barela në ditë.

3. Për shfrytëzimin e vendburimeve margjinale të zbuluara, ose të kthyera në margjinale nga shfrytëzimi i tyre, Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë vendime të posaçme për lehtësimin e sistemit fiskal, me qëllim vetëm që këto lloj vendburimesh të kthehen në ekonomishtë të shfrytëzueshme.

Neni 2

Për efekt të llogaritjes së fitimit të realizuar, kontraktuesit i njihen si kosto shpenzimet kapitale, ato operative e administrative etj. (specifikimet përkatëse bëhen në çdo marrëveshje hidrokarburesh e miratohen nga ministri) dhe lejohet shlyerja e tyre nga të ardhurat e fituara sipas kritereve të pranuar nga ministri, si dhe sipas praktikave ndërkombëtare të industrisë së naftës që zbatohen në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Neni 3

Kontraktuesi dhe nënkontraktuesit e tij përjashtohen nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet etj.

Gjithashtu, trajtohen njëjloj si në paragrafin e mësipërm të këtij neni edhe mjetet e jetesës së punonjësve të huaj të kontraktuesit e nënkontraktuesve të tij, që lidhen me operacionet e naftës, në rast se nuk vendoset ndryshe nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Punonjësit e huaj të kontraktuesit dhe nënkontraktuesve të tij përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale që sigurohen nga operacionet e naftës.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Aleksandër Mexi

Sali Berisha